



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
QENDRA NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE**

Rregullore

**Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave
shtetërore për trafikun detar**

Miratuar me Urdhër të Drejtorit Administrativ Nr. 16 Datë 30.03.2022

Durrës, Mars 2022

Punuar nga: Grupi i punës i ngritur me Urdhër Nr. 11, datë 22.02.2022 të Drejtorit Administrativ të QNOD-së

Statusi: Aktiv
Datë: 30.03.2022
Faqe: 18 (tetëmbëdhjetë)

Dërguar për mendim institucioneve, si më poshtë:

- Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
- Forcës Detare/ Roje Bregdetare
- Policisë Kufitare dhe Migracionit
- Drejtorisë së Përgjithshme Detare
- Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
- Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
- Strukturës përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe statistikave në mjedis
- Strukturës përgjegjëse për përpunimin e informacionit dhe statistikave në turizëm
- Autoritetit Portual dhe Porteve Detare Shqiptare
- Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
- Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU)

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt organizimin, funksionimin e brendshëm dhe përcaktimin e procedurave për Bazën e të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar (BDHSHTD).

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla të përgjithshme organizative dhe procedura transparente, për të siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të ligjit nr 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ligjit nr. 9428 datë 13.10.2005 “Mbi raportimin e formaliteteve për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e shteteve anëtare të Komunitetit”, VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, VKM Nr. 892, datë 21.12.2011 “Për miratimin e rregullores “Për formalitetet e anijeve që operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë” dhe VKM Nr. 103, datë 16.02.2022 “Për Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”.

Neni 4

Fusha e veprimit

Kjo rregullore e shtrin efektin e saj te të gjithë institucionet/strukturat pjesëmarrëse në sistemin e BDHSHTD dhe përfshin të gjithë përdoruesit, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Përdoruesit e jashtëm dhe të gjithë subjektet e interesuara, që në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kanë të drejtën e aksesit në sistemin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar duhet të informohen për këtë rregullore përsa i përket përmbushjes së rolit të tyre.

Neni 5

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat dhe përkufizimet e mëposhtme, kanë këto kuptime:

1. “Audit Log” – është historiku i veprimeve të përdoruesve të sistemit BDHSHTD.
2. “AKSHI” - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
3. “AKU” - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
4. “BDHSHTD” - Baza e të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar

5. “DPD” - Drejtoria e Përgjithshme Detare
6. “OSHKSH” - Operatori Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
7. “IMO” - Organizata Ndërkombëtare Detare
8. “Pjesëmarrës” – janë të gjithë institucionet dhe strukturat që kanë përgjegjësi dhe interesa në det, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
9. “PKM” - Policia Kufitare dhe Migracionit
10. “QNOD” - Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
11. “RB” - Roja Bregdetare
12. “TIK” - Teknologjia Informacionit dhe Komunikimit

Krahas tyre, termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 6

Parimet për sigurinë e sistemit elektronik

Siguria e sistemit të Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar është e mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Parimi i ligjshmërisë – të dhënat do të përpunohen në një bazë të dhënash që i përket QNOD-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i përshtatur me ligjin për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore;
- Parimi i gjurmueshmërisë – Të gjitha veprimet mbi të dhënat, kohën e ndryshimit apo përditësimit të tyre, dhe çdo lloj parametri teknik i ndërlidhur me to që garanton integritetin, sigurinë dhe autenticitetin, si dhe veprimet e përdoruesve, administruesve dhe sistemeve ekelektronike të tjera, të sistemit Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar duhet të ruhen në një sistem kontrolli me format të përshtatshëm dhe lehtësisht të lexueshëm duke ofruar mundësinë e kontrollit dhe auditimit nga instancat zyrtare përkatëse;
- Parimi i përdorimit të të dhënave në formë elektronike – mundësitë e ofruara nga përditësimi i të dhënave në formë elektronike do të përdoren në maksimum, ato mbizotërojnë nga përditësimi manual dhe në letër për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore. Të dhënat për aq sa është e mundur do të përpunohen në formë digitale;
- Parimi i unitetit – baza e të dhënave duhet të jetë e aftë të këmbejë, të ndërveprojë dhe të verifikojë të dhënat.

Neni 7

Niveli i sigurisë

Niveli i sigurisë së sistemit është i përcaktuar në përputhje me disponimet e bëra në nenin 17, 18 dhe 19 të vendimit nr. 945, datë 02.11.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore".

Për shkak të integritetit të të dhënave, niveli i sigurisë për BDHSHTD është i lartë. Të dhënat e deklaruara që ngarkohen duhet të jenë të sakta dhe të plota.

Neni 8

Institucionet/Strukturat ligjzbatuese

Institucionet/strukturat ligjzbatuese, subjekt i kësaj rregulloreje janë: AKSHI, QNOD, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Dogana, Antikontrabanda Detare, Policia Kufitare dhe Migracionit, Roje Bregdetare, Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, Struktura përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe statistikave në mjedis, Struktura përgjegjëse për përpunimin e informacionit dhe statistikave në turizëm, Autoriteti Portual dhe Portet Detare Shqiptare, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Dispaceria Peshkimit dhe Agjencitë Detare.

Neni 9

Të dhënat që administrohen në sistem

Në sistem administrohen të gjitha lëvizjet dhe veprimtaritë e anijeve (mjeteve lundruese), që hyjnë/dalin në/nga Portet Detare Shqiptare dhe lëvizin/lundrojnë në ujërat tona, në përputhje me konventën ndërkombëtare IMO FAL dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Baza e të dhënave mundëson informacion të integruar në kohë reale të të gjitha mjeteve të lundrimit, me natyrë tregtare ose jo. Këto të dhëna përbëjnë bazën e të dhënave shtetërore të cilat do të administrohen në Sistemin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar.

Neni 10

Administrimi dhe ruajtja e të dhënave

Administrimi dhe ruajtja elektronike e kësaj baze të dhënash shtetërore, pranë AKSHI-t dhe në administrim të QNOD-së, sipas kushteve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, mundëson siguri në informacionin e regjistruar, fleksibilitet, aksesueshmëri në çdo kohë të të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Përdoruesit e sistemit

Përdoruesit e sistemit, kategorizohen në nivel/rol, si më poshtë:

- Administrator:
 - a) Administrator i sistemit “Sistemi i Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”
 - b) Administrator i bazës së të dhënave shtetërore të trafikut detar
- Përdorues sistemi

Roli dhe përgjegjësitë e përdoruesve

a. Administratori i sistemit (Njësia TIK e AKSHI-t në QNOD)

Administratori i sistemit të Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar (në përbërje të Njesisë TIK të AKSHI-t pranë QNOD-së), është përgjegjës për infrastrukturën e teknologjisë, informacionit dhe të komunikimit (TIK). Administratori gëzon të drejtën e plotë të aksesit në të gjithë sistemin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar.

Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, ai mbështetet/ndihmohet edhe nga specialistë të tjerë të AKSHI-t, në përputhje me këtë rregullore apo me aktet e tjera normative.

Administratori i sistemit:

- ka të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në sistem, në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, roleve të përdoruesve, me të drejta administrative.
- ka të drejta administrative mbi sistemin dhe bazën e të dhënave në rolet: administrator, raportues dhe auditues.

Roli i administratorit të sistemit përfshin të gjitha privilegjet e nevojshme për të garantuar mbarëvajtjen e sistemit. Ai ka të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave konfigurorese në sistem.

Administratori i sistemit përgjigjet për:

- Regjistrimin/fshirjen/modifikimin apo aktivizimin/ç'aktivizimin e përdoruesve të sistemit dhe konfigurimin e roleve përkatëse.
- Rishikimin e logeve të sigurisë të sistemit dhe aplikacioneve, si dhe Auditimin e logeve të sigurisë të bazës së të dhënave.
- Ndjekjen rregullisht të procedurave që kryhen për *backup* dhe *restore*.
- Monitorimin e infrastrukturës së sistemit.

Administratori i sistemit bashkëpunon me operatorin ekonomik që kryen mirëmbajtjen e sistemit për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu bashkëpunon ngushtë me administratorin e bazës së të dhënave.

b. Administrator i bazës së të dhënave

Administratori i bazës së të dhënave shtetërore për trafikun detar është specialisti i bazës së të dhënave në QNOD.

Administratori i bazës së të dhënave përgjigjet për:

- Krijimin/modifikimin/fshirjen e përdoruesve të sistemit dhe roleve të tyre përkatëse, në rastet kur mungon administratori i sistemit.
- Administrimin e të dhënave të sistemit.
- Kontrollin mbi veprimet e përdoruesve në sistem.

- Rishikimin e logeve të sigurisë të bazës së të dhënave.

Administratori i bazës së të dhënave bashkëpunon ngushtë me administratorin e sistemit dhe e ndihmon atë, në rastet kur kërkohet, për zgjidhjen e problemeve në sistem në kuadër të regjistrimit të përdoruesve, roleve përkatëse dhe modifikimit të të dhënave konfigurorese në sistem.

c. Përdorues të sistemit

Përdoruesit e autorizuar të Sistemit të Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar, janë:

- a) koordinatorët institucionalë të strukturave pjesëmarrëse në QNOD, si dhe oficerët e shërbimit/civil të turnit në sallën operacionale të QNOD-së, të cilët kanë të drejtë leximi të të dhënave, praktikave të mjeteve lundruese, të raporteve të inspektimit, të riskut, etj. brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, si dhe të shkëmbejnë informacion ndërmjet tyre, në interes të nevojave operacionale.
- b) inspektorët/administratorët e sallës operacionale në QNOD, të cilët kanë të drejtë leximi të të gjitha të dhënave të mjeteve lundruese, praktikave të mjeteve lundruese, inspektimeve, riskut dhe raporteve. Ata gjenerojnë raportet përkatëse.
- c) agjentët detarë, kapitenët e anijes dhe përfaqësuesit e autorizuar të mjeteve lundruese, të cilët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë regjistrimi të përdoruesve në sistem dhe kanë të drejta leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave dhe praktikave mbi mjetet lundruese për të cilët kanë autorizim të përfaqësojnë.

Përdorues të sistemit janë gjithashtu edhe përfaqësues nga struktura, institucione, autoritete, si më poshtë:

- d) Drejtoria e Përgjithshme Detare me të drejta leximi, shkrimi/modifikimi, anulimi ose konfirmimi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese, inspektimeve (nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit dhe Kontrolli Shtetëror Portual), si dhe të drejta leximi të njoftimeve e raporteve të mjeteve lundruese me risk;
- e) Autoriteti Portual/portet detare (shtetërore dhe private) me të drejta leximi, shkrimi/modifikimi, anulimi ose konfirmimi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese, si dhe të Planit të Portit;
- f) Dogana dhe Antikontrabanda Detare me të drejta leximi, shkrimi/modifikimi, anulimi ose konfirmimi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese, si dhe të inspektimeve e raporteve doganore të mjeteve lundruese;
- g) Policia Kufitare dhe Migracionit me të drejta leximi, shkrimi/modifikimi, anulimi ose konfirmimi të praktikave të mjeteve lundruese përkatëse, si dhe të raporteve të kontrollit të mjeteve lundruese (kryer nga PKM);

- h) Roja Bregdetare me të drejta leximi dhe shkrimi/modifikimi të të dhënave të mjeteve lundruese të RB-së, të drejtë leximi të praktikave e raporteve të mjeteve lundruese përkatëse;
- i) Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës me të drejta leximi dhe shkrimi/modifikimi të të dhënave të mjeteve lundruese të peshkimit, të mjeteve lundruese të Inspektoratit të Peshkimit, të raporteve të inspektimit për mjetet lundruese të peshkimit, si dhe të drejta leximi të raporteve të tjera për mjetet lundruese të peshkimit;
- j) Inspektori i shëndetësisë (struktura vendore e OSHKSH apo doktori/inspektori i shëndetësisë së Autoritetit Portual) me të drejta leximi, shkrimi/modifikimi, anulimi ose konfirmimi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese, si dhe të raporteve të inspektimit të shëndetësisë;
- k) AKU (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit) me të drejta leximi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese tregtare;
- l) Struktura përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe statistikave në mjedis me të drejta leximi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit;
- m) Struktura përgjegjëse për përpunimin e informacionit dhe statistikave në turizëm me të drejta leximi të praktikave përkatëse të mjeteve lundruese turistike.

Përdoruesit kanë të drejta shkrimi, editimi, leximi, konfirmimi apo anulimi të të dhënave, mjeteve, praktikave, etj, sipas roleve përkatëse.

Përdoruesit e regjistruar aksesohen në URL: www.vesselsdata.gov.al duke përdorur paisje, si: kompjuter, laptop, tablet, etj.

Neni 12

Procedura për anëtarësim në sistem

- Për të siguruar aksesin në sistemin e BDHSHTD, çdo punonjës duhet të regjistrohet.
- Për t'u regjistruar, fillimisht duhet të plotësohet formulari me të dhënat personale (sipas Aneksit I ose II) dhe dërgohet zyrtarisht në QNOD.
- Më pas, personi përgjegjës (administratori i sistemit, ose në mungesë të tij administratori i bazës së të dhënave), pranë QNOD-së bën të mundur regjistrimin në sistem dhe me e-mail/telefon njofton përdoruesin për hapjen e llogarisë.
- Në rastin se punonjësi ndërpret marrëdhëniet e punës apo ndryshon detyrë/pozicion në institucionin përkatës, brenda 5 ditëve, institucioni përkatës duhet të informojë zyrtarisht QNOD-në, me qëllim ç'aktivizimin e tij në sistem apo ndryshimin e rolit, sipas rastit.
- QNOD (administratorët e sistemit/bazës së të dhënave) monitoron dhe përditëson listën e të gjithë përdoruesve të sistemit.
- Lista e të gjithë përdoruesve me të dhënat e llogarive të tyre, si dhe formularët e aplikimit administrohen në një dosje të veçantë nga Njësia TIK e AKSHI-t, pranë QNOD-së.

Neni 13

Identifikimi dhe autentikimi

Emri i përdoruesit, fjalëkalimi për përdoruesin e sistemit

Çdo përdorues i sistemit të Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar duhet të jetë i pajisur me emër përdoruesi unik. Moduli kontrollues i aksesit duhet të identifikojë çdo përdorues të paautorizuar që modifikon/përdor informacionin në sistemin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar. Kërkesat e sigurisë për identifikimin e përdoruesve, përfshijnë:

- Çdo përdorues pajiset me identifikues personal.
- Identifikuesi personal përbëhet nga *username* (emri.mbiemri) i përdoruesit.
- Çdo përdorues i sistemit pajiset me fjalëkalim unik për të mundësuar akses në sistem, sipas rolit përkatës.
- Çdo përdorues do të jetë përgjegjës për përdorimin dhe keq-përdorimin e identifikuesit të tyre personal në përputhje me rolin përkatës.

Neni 14

Kontrolli i anëtarësimit në grup

Ky është kontrolli mujor i sigurisë, i cili kryhet nga administratori i sistemit (njësia TIK e AKSHIT në QNOD).

Administratori i sistemit verifikon:

- Nëse ka probleme (siç janë përdoruesit në grupin/rolin e gabuar), Administratori i sistemit regjistron gabimin dhe merr masat e duhura.
- Nëse nuk ka probleme, në përfundim të kontrollit administratori i sistemit regjistron rezultatet.

Neni 15

Zhblllokimi i Llogarive

Në rast se përdoruesi vendos tre herë gabim fjalëkalimin në sistem, llogaria e tij bllokohet. Nëse llogaria është e bllokuar përdoruesi nuk mund të aksesojë sistemin, as të procedojë me ndryshimin e password.

Për të bërë të mundur zhblllokimin e llogarisë, përdoruesi me anë të e-mailit personal me të cilin është regjistruar në sistemin BDHSHTD, duhet të njoftojë QNOD, në e-mailin: trafikudetar_support@imoc.gov.al.

Modulet kryesore të sistemit

Për të gjitha mjetet lundruese që kanë si destinacion portet e hapura të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Agjencive Detare, kapitenëve apo përfaqësuesve ligjor, dërgojnë njoftimin paraprak 24-72 orë përpara mbërritjes. Ndërsa në rastet kur koha e lundrimit është nën 24 orë, njoftimi dërgohet në momentin e nisjes së anijes.

Pasi përdoruesi i sistemit logohet në sistem me kredenciale të sakta, ai do të drejtohet në faqen kryesore të sistemit në të cilën do të aksesojë të gjithë seksionet sipas të drejtave që ka përdoruesi.

Fillimisht verifikohet nëse mjete lundrues ekziston i regjistruar në sistem. Nëse në sistem nuk është i regjistruar mjete lundrues, atëherë regjistrohet mjete. Personi që regjistron praktikën e mjetit lundrues në sistem, fillimisht regjistron mjetin lundrues. Nëse mjete lundrues është i regjistruar, verifikohen të dhënat e mjetit lundrues nuk kanë ndryshuar. Nëse ka ndryshime, përditësohen të dhënat në sistem.

- Moduli thirrjeve portuale

Në modulin:

- **Thirrje Portuale/ Port Calls** - do të regjistrohen të gjitha praktikat e mjeteve lundruese.
 - a. Për mjetet lundruese tregtare (*merchant ships*) mund të kryhet:

- Njoftimi paraprak / para mbërritjes,
- Njoftimi mbërritjes,
- Njoftimi i nisjes.

Mjetet lundruese tregtare (*merchant ships*) që regjistrohen në sistem janë mjetet *cargo*, tanker, cisternë, tragete, mjetet për furnizim bordi, etj. Sipas rregullores dhe konvetës FAL, agjenti apo përfaqësuesi ligjor duhet të dërgojë një njoftim paraprak tek autoritetet përkatëse.

Këtu regjistrohen praktikat nga agjenti, dhe aksesohen praktikat nga autoritetet përkatëse (Autoriteti Portual/Portet Detare Shqiptare, Kapiteneria e Portit, Policia Kufitare dhe Migracionit, Antikontrabanda Detare, Dogana, Inspektori i Shëndetësisë, AKU, etj.), sipas fushës së përgjegjësisë. Agjenti ngarkon në sistem formularët FAL (FAL 1- FAL 7), deklaratën e shëndetësisë, deklaratën e mbetjeve, manifestin e cargos, certifikatat (sigurisë, tonazhit, vajit, etj), *check*-listën e bunkerazhit, etj, në varësi të llojit të anijes. Mënyra e plotësimit në sistem, përgjithësisht është në tre mënyra (në pdf, excel sipas template-t që shkarkohet nga sistemi dhe në web form).

Autoriteti Portual/Porti Detar përcakton plan portin (kalatën) ku do të ankorohet mjete lundrues.

Autoritetet përkatëse duhet të konfirmojnë ose anulojnë praktikën (thirrjen portuale) brenda 1 ore nga momenti që është bërë kërkesa në sistem nga agjenti, kapiteni anijes apo përfaqësuesi ligjor.

b. Për mjetet lundruese turistike do të ketë nëndarje:

- për lundrim për qëllime tregtare,
- për lundrim për qëllime jotregtare,
- anije që kryejnë lundrim brenda vendit.

Për mjetet lundruese turistike *për qëllime tregtare dhe për qëllime jo-tregtare*, në sistem regjistrohen njoftimet për nisje dhe mbërritje.

Për mjetet lundruese turistike për qëllime tregtare (ku përfshihen jahtet, veliere, etj), agjenti ngarkon në sistem formularët FAL 1, FAL 5, FAL 6, formularin e mbetjeve, certifikatat e mjetit lundrues, etj. Autoritetet përkatëse (PKM, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Autoriteti Portual/Porti Detar) duhet të konfirmojnë ose anulojnë praktikën (thirrjen portuale) brenda 1 ore nga momenti që është bërë kërkesa nga agjenti, kapiteni anijes apo përfaqësuesi ligjor.

Për mjetet lundruese turistike për qëllime jotregtare (mjete të vogla lundruese, si skafe, etj) agjenti ngarkon në sistem formularin FAL 1, formularin e mbetjeve, certifikatat e mjetit lundrues, etj. Autoritetet përkatëse (PKM dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare) duhet të konfirmojnë ose anulojnë praktikën (thirrjen portuale) brenda 1 ore nga momenti që është bërë kërkesa nga agjenti, kapiteni anijes apo përfaqësuesi ligjor.

Për mjetet lundruese turistike me flamur shqiptar mundësohet leja mujore, e cila duhet të regjistrohet në sistem nga Drejtoria e Përgjithshme Detare/Kapiteneria e Porteve.

Çdo lëvizje e mjeteve turistike që lundrojnë brenda ujërave apo porteve tona, regjistrohet në sistem nga Kapiteneria e Portit përkatës (nga ku bëhet dalja/nisja e mjetit lundrues).

c. Për mjetet lundruese të peshkimit do të mundësohet leja mujore, praktika daljes/nisjes dhe mbërritjes.

Për mjetet lundruese të peshkimit të cilat kryejnë detyra rutinore brenda ujërave tona (kombëtare), Kapiteneria e Porteve duhet të plotësojë lejen mujore. Sa herë që anija do të lundrojë, duhet të kryhet praktika e nisjes dhe mbërritjes së anijes. Praktika e nisjes dhe mbërritjes së anijes së Peshkimit, që dalin nga Porti Durrësit duhet të plotësohet në sistem nga Dispeceria e Peshkimit, Durrës, ndërsa në portet në të cilat nuk ka Dispeceri Peshkimi, por ka shërbim të PKM duhet të kryhet nga PKM, deri në momentin që do të ketë dispeceri peshkimi.

d. Për anijet lundruese të institucioneve do të mundësohet regjistrimi i çdo dalje mjeti për qëllime të ndryshme, si: patrullime, kontrole, operacione detare, etj. Regjistrimi në sistem kryhet nga institucioni përkatës që ka mjete lundruese dhe i përdor për qëllimet përkatëse.

Çdo institucion kryen praktikën e mjetit lundrues të institucionit të tij.

- **Profili i riskut të Anijes**

Të gjitha anijet në sistemin e informacionit caktohen, si: rrezik i lartë, standard ose i ulët bazuar në parametrat historikë. Risku kalkulohet sipas indikatorëve, ku çdo indikator ka peshën e tij, i cili pasqyron ndikimin relativ të secilit parametër në rrezikun e përgjithshëm të anijes. Modeli i përdorur është ai i përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

Parametrat për profilin e rrezikut të anijeve të llogaritura në sistem janë:

- Lloji i anijes
- Mosha e anijes
- Flamuri (Shteti Flamurit)
- Performanca e Kompanisë RO
- Performanca e Kompanisë ISM
- Numri i mangësive
- Numri i ndalimeve brenda 36 muajve të mëparshëm

Shënim: Nëse do të ketë ndryshime të kriterëve të përcaktimit të riskut të anijes, elementëve, standardeve, indikatorëve të riskut, parametrave të përcaktuar apo profilit të riskut të anijes, Drejtoria e Përgjithshme Detare duhet t'i dërgojë zyrtarisht këto ndryshime në QNOD (njësisë TIK të AKSHI-t), me qëllim konfigurimin dhe përshtatjen e tyre në sistem.

- **Moduli Inspektive**

Në këtë modul regjistrohen inspektimet që kryhen nga Shëndetësia, Antikontrabanda Detare, Dogana, Policia Kufitare dhe Migracionit, Kontrolli Shtetëror i Flamurit etj, sipas roleve përkatëse (Inspektimi i Shëndetësisë, inspektimi Antikontrabandës Detare dhe Doganës, kontrolli Policisë së Kufirit dhe Migracionit, inspektimi i Kontrollit Shtetëror të Flamurit dhe Kontrollit Shtetëror Portual, etj) nga përdoruesit e sistemit.

Për çdo rast që kryhen inspektime të mjeteve lundruese (tregtare, turistike, etj), ato regjistrohen në sistem nga strukturat e mësipërme ligjzbatuese.

- **Moduli Raporteve**

Në këtë modul mund të aksesohen raporte të ndryshme mbi thirrjet portuale, inspektimet e kryera, të dhëna statistikore, etj, nga përdoruesit e sistemit, në varësi të rolit që kanë në sistem.

Neni 17

Kontrollet e sigurisë për bazën e të dhënave

Kontrollet e sigurisë për bazën e të dhënave klasifikohen në "parandaluese", "dedektuese" dhe "evidentuese" kundrejt aksesit të pa autorizuar.

Kontrollet e sigurisë kryhen me qëllim që të parandalojnë aksesin e pa autorizuar në sistem ose bazë të dhënash shtetërore.

Kontrollet e sigurisë kryhen nga AKSHI.

Neni 18

Ngjarje të parashikuara dhe të paparashikuara

- 1- Një ngjarje e parashikuar e sistemit ndodh kur në mënyrë të parashikueshme ndodh ndërprerja e funksionimit normal të punës së sistemit, për një kohë të shkurtër.
- 2- Një ngjarje e paparashikuar e sistemit ndodh në mënyrë të menjëhershme, të papritur kur përbërës të sistemit dalin jashtë parametrave të përdorimit normal duke krijuar një gjendje jashtëshërbimi të sistemit.
- 3- Në të dyja rastet kur ndodh një defekt në sistem, njoftohet menjëherë Njësia TIK e AKSHI-t pranë QNOD-së, me qëllim marrjen e masave të duhura për kthimin sa më shpejt në funksionalitet të plotë të sistemit.
- 4- Në rast të një defekti të zgjatur në sistem dhe në rastet kur është e domosdoshme, QNOD komunikon dhe konsultohet me AKSHI-n dhe institucionet/strukturat pjesëmarrëse për shpalljen e një plani emergjence në funksion të vijimësisë së punës, deri në zgjidhjen e problemit, duke përdorur të gjitha format e parashikuara në protokollet përkatëse.

Neni 19

Regjistrimi ngjarjeve

Njësia TIK e AKSHI-t në QNOD krijon një regjistër ku regjistrohen të gjitha ngjarjet (parashikuara dhe paparashikuara), në funksion të krijimit të një historiku me qëllim mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe rritjen e efikasitetit të sistemit.

Në fund të çdo muaji kalendarik, apo rast pas rasti në fund të çdo ngjarje, Njësia TIK e AKSHI-t në QNOD, duhet të raportojë në strukturat e prore dhe institucionin përfitues.

Neni 20

Administrimi i ndryshimeve dhe kontrolli i tyre

- 1- Ndryshimet në sistemin BDHSHTD janë, si më poshtë:
 - a) Ndryshime funksionale dhe teknike të sistemit
 - b) Ndryshime në përmbajtjet dhe formën e pasqyrave të cilat kërkojnë instalimin e një version të ri
 - c) Ndryshime në komponentët *hardware*, *software* dhe lidhje të sistemit.

- 2- AKSHI njofton dhe udhëzon QNOD (të gjithë përdoruesit e sistemit) para zbatimit të ndryshimeve të planifikuara të sistemit, kur këto ndryshime kanë ndikim tek përdoruesit e sistemit.
- 3- Çdo ndryshim testohet në mjedisin test para se të implementohet në sistem.
- 4- Institucionet/strukturat pjesëmarrëse grumbullojnë problematikat apo shqetësimet që vijnë nga përdoruesit e tyre dhe së bashku me sugjerimet përkatëse për zgjidhje, i përcjellin zyrtarisht në QNOD.
- 5- QNOD, pasi analizon problematikën dhe sugjerimet përkatëse, në interes të përmirësimit të efikasitetit të sistemit, ia adreson për zgjidhje AKSHI-t.

Neni 21

Asistenca për përdoruesit e sistemit

QNOD ka një person kontakti me qëllim ofrimin e ndihmës për përdoruesit e sistemit.

Përdoruesit e sistemit mund të adresohen te personi i kontaktit, për problemet e lidhura gjatë punës me sistemin, në adresën: trafikudetar_support@imoc.gov.al.

Neni 22

Përgjegjësia në rastin e forcave madhore

- 1- Përdoruesit e sistemit nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet apo mospërbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, që vijnë si pasojë e forcave madhore.
- 2- Përdoruesit që nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e veta për shkaqet e përcaktuara në pikën 1, duhet:
 - a) Të njoftojnë QNOD mbi shkakun dhe shkallën që ka penguar atë në përmbushjen e detyrimeve.
 - b) Të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve sa më shpejt të jetë e mundur dhe njëkohësisht, të përpiqen të minimizojë efektet negative të shkaqeve të përcaktuara në pikën 1.

Neni 23

Konfidencialiteti

1. Punonjësit e institucioneve ligjzbatuese, përdorues të sistemit BDHSHTD të cilët kanë në përdorim informacionin e nevojshëm dhe akses në sistem, i nënshtrohen të gjitha detyrimeve dhe sanksioneve sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse, që rregullojnë normat dhe rregullat e konfidencialitetit për punonjësit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe pas largimit të tyre nga puna.

2. Drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse udhëzojnë personelin në vartësi të tyre, i cili ka të drejta për përdorimin e informacionit të depozituar nëpërmjet sistemit BDHSHTD, për ruajtjen e konfidencialitet mbi këtë informacion, në përputhje me rregullat dhe normat e konfidencialitetit dhe me dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 24

Zbatueshmëria e rregullores

1. Përgjegjës për përdorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje janë të gjithë institucionet/strukturat e përcaktuara më lart (neni 8).
2. Administratori i sistemit dhe i bazës së të dhënave i paraqesin çdo muaj Drejtorit Administrativ të QNOD-së një raport mbi zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Për zbatueshmërinë e rregullores, QNOD mund të organizojë takime rast pas rasti, me përfaqësues të drejtorive/strukturave ligjzbatuese.

Neni 25

Amendime të rregullores

Kjo rregullore amendohet, sa herë është e domosdoshme, nisur nga propozimet konkrete të drejtuesve të institucioneve/strukturave ligjzbatuese, që janë përdorues të sistemit “Baza e të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”.

Neni 26

Përgjegjësitë dhe sanksionet

Çdo përdorues i sistemit të Bazës së të Dhënave për Trafikun Detar apo subjekt tjetër i autorizuar përcaktuar në këtë rregullore, mban përgjegjësi për ruajtjen dhe mospërhapjen e informacioneve.

Në rast se veprimet apo mosveprimet e përdoruesve bien në kundërshtim me VKM Nr. 103, datë 16.02.2022 dhe me këtë rregullore apo me çdo akt tjetër ligjor, që rregullon administrimin dhe sigurinë e bazës së të dhënave, këta persona mbajnë përgjegjësi individuale, pavarësisht nëse kjo është apo jo e parashikuar në kontratën individuale të punës.

Drejtori Administrativ i QNOD-së, informon zyrtarisht drejtuesit e institucioneve/strukturave ligjzbatuese, për mos zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me sistemin BDHSHTD, nga punonjësit në vartësi të tyre.

Neni 27

Dispozita tranzitore

Ngarkohen në zbatimin e kësaj rregulloreje: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Dogana dhe Antikontrabanda Detare), Policia Kufitare dhe

Migracionit, Roja Bregdetare, Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, Struktura përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe statistikave në mjedis, Struktura përgjegjëse për përpunimin e informacionit dhe statistikave në turizëm, Autoriteti Portual dhe Portet Detare Shqiptare (private dhe shtetërore), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Agjencitë Detare, Dispeceria e Peshkimit dhe Komandantët e mjeteve lundruese.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë:

Aneksi I - Formulari i krijimit të përdoruesit në Sistemin Baza e të Dhënave për Trafikun Detar (për agjencitë)

Aneksi II - Formulari i krijimit të përdoruesit në Sistemin Baza e të Dhënave për Trafikun Detar (për Institucionet/Autoritetet që do e përdorin)

ANEKSI I

**Formulari i krijimit të përdoruesit në Sistemin Baza e të Dhënave për
Trafikun Detar (për agjencitë)**

Shërbimet e ofruara nga Sistemi Baza e të Dhënave për Trafikun Detar janë në dispozicion (sipas roleve përkatëse) për të gjithë palët e interesuara (shtetërore dhe private) të përcaktuara në VKM Nr. 103, datë 16.02.2022 për “Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”.

Për tu bërë pjesë e sistemit, ju lutemi plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në rrugë zyrtare në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Për çdo koment ose pyetje ju lutem të kontaktoni në adresën e-mail: imoc@imoc.gov.al

Ju lutem shkruani qartë të dhënat e Agjencisë Detare (Me gërma kapitale)

Emri Agjencisë: _____

NIPT: _____

Adresa e email-it: _____

Nr. Cel: _____

Shteti Regjistrimit të Agjencisë: _____

Ju lutem shkruani qartë të dhënat e Agjentëve që do të përdorin sistemin (Me gërma kapitale)

Emër Mbiemër: _____

NID: _____

Pozicioni/Detyra: _____

Emri Agjencisë: _____

Portet ku operojnë: _____

Adresa e email-it: _____

Nr. Cel: _____

Unë i nënshkruari pohoj se e kam plotësuar informacionin në mënyrë të saktë dhe se mbaj përgjegjësi personale për çdo të dhënë të plotësuar gabim ose të pasaktë.

Firma

Data

Miratuar nga: _____

* Ky formular duhet të shoqërohet me një kopje të dokumentit të regjistrimit/licencimit të Agjencisë.

ANEKSI II

Formulari i krijimit të përdoruesit në Sistemin Baza e të Dhënave për Trafikun Detar (për Institucionet/Autoritetet që do e përdorin)

Shërbimet e ofruara nga Sistemi Baza e të Dhënave për Trafikun Detar janë në dispozicion (sipas roleve përkatëse) për të gjithë palët e interesuara (shtetërore dhe private) të përcaktuara në VKM Nr. 103, datë 16.02.2022 për “Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore për Trafikun Detar”.

Për tu bërë pjesë e sistemit, ju lutemi plotësoni këtë formular dhe dërgojeni në rrugë zyrtare në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Për çdo koment ose pyetje ju lutem të kontaktoni në adresën e-mail: imoc@imoc.gov.al

Ju lutem shkruani qartë. (Me gërma kapitale)

Emër Mbiemër: _____

NID: _____

Grada: _____

Pozicioni/Detyra: _____

Spektori: _____

Institucioni: _____

Vendndodhja: _____

Adresa e email-it: _____

Nr. Cel: _____

Zgjidhni të drejtat në sistem: leximi dhe/ose editimi dhe/ose konfirmimi

Regjistrimi Anijes: _____

Praktika për Anijet tregtare: _____

Praktika për Anijet turistike: _____

Praktika për Anijet e peshkimit: _____

Praktika për Anijet e Institucionit tuaj: _____

Inspektimi: _____

Unë i nënshkruari pohoj se e kam plotësuar informacionin në mënyrë të saktë dhe se kam lexuar rregulloren e sistemit Baza e të Dhënave për Trafikun Detar dhe se jam dakord me ato që thuhet në të. E kuptoj që çdo përpjekje për të mos ndjekur këtë rregullore apo përdorimi i paligjshëm i shërbimit kanë për pasojë ndërprerjen e shërbimeve dhe /ose masa të tjera.

Firma

Data

Miratuar nga: _____